

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E HËNË 8 NËNTOR 2021

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në vend që sot të diskutojmë gjerë e gjatë për disa para të tjera që do të merren borxh, siç e patë, dëgjuam një elegji pa fund të lumturisë së një qeverie që qenka shumë e zonja për të marrë borxhe. Edhe shqiptari më i thjeshtë e kupton fare mirë që borxhi është një veprim i madh që bëhet në një ditë halli të madh, për të zgjidhur disa probleme të mëdha të caktuara. Asnjë nga ata që kënduan dhe recituan elegjinë e lumturisë së borxhit nuk thanë dot cila ishte vepra e madhe infrastrukturore që ky borxh, që rritet pambarimisht, ndërtoi; cilat ishin shërbimet e jashtëzakonshme që i lanë pa gojë qytetarët, që funksionojnë kaq mirë dhe që ia vlen ta marrim këtë borxh apo cila gjë funksionon në këtë sistem energjetik, pas qindra miliona eurove (të publikuara këtu, jo të thëna nga unë) të dhëna këtij sistemi energjetik, që na krijon këtë situatë të jashtëzakonshme. Kemi qeveri që mendon sot për sot dhe merr disa para borxh për t'i bërë rrush e kumbulla apo kemi një qeveri që projektohet, i ka gjërat e qarta dhe e di se ku po shkon? Le ta ndajmë bashkë si punon kjo qeveri me ato që thonë vetë këta dhe të mos u referohemi atyre që themi ne.

Një ditë e gjysmë përpara se të shpallte kataklizmën e krizës energjetike Edi Rama mbajti një fjalë në Abu Dabi, ku tha që shumë shpejt Shqipëria do të bëhej eksportuese neto e energjisë. Nuk foli për ndonjë krizë dhe as nuk tregoi ndonjë shqetësim për krizën që po vinte, se kriza nuk ishte tërmet që ra brenda 24 orëve, 2 minutave apo 10 minutave. Po kjo qeveri dhe ky Kryeministër në 15 prill (kuptohet në fushatë elektorale premtojnë të gjitha ato që s'mund të bëhen as për 400 vjet) tha: "Nuk do të harxhojmë më asnjë lek, por do të shesim. Kjo nuk është një ëndërr e parë në gjumë". Këto nuk janë fjalët e mia. Në rast se këtij Kryeministri nuk i shkon metri i vështrimit më shumë se 2 muaj, 3 muaj apo 4 muaj, kjo është qeveri e vdekur. Në datën 9 tetor u shpall plani për të marrë 200 milionë euro borxh, sepse të gjithë e kuptuan që e gjithë kjo bubullijmë për krizë ishte për të justifikuar dhënien e 200 milionë eurove OSHEE-së. Çfarë ndodh me OSHEE-në? Ta dinë shqiptarët, ata që nuk marrin dot rrogë. Në vitin 2017 OSHEE-ja shpenzoi rreth 30 milionë dollarë për paga, kurse në vitin 2018 shpenzoi 50 milionë dollarë për paga. Pra, fondi i pagave u rrit me 20 milionë dollarë. Pse? Sepse janë mirë, kanë para. Kjo është një ndërmarrje e madhe shtetërore që administron energjinë. Pse është ky gëzim i madh që ndajnë para, gjashtë mijë e ca, ndërkohë që të tjerëve nuk u rriten pagat dhe pensionet? 600 milionë euro investime gjoja për transformatorët, ndërkohë që gjenden e transformatorëve e dimë dhe qytetarët e shikojnë se si digjen përditë. Makina me leasing e të tjera.

Tymi i korrupsionit dhe batërdisë vazhdon drejt, ndërkohë që jemi në krizë apokaliptike, që nuk e ka parë dynjaja ndonjëherë, thënë nga këta. Njëherazi, pasi kriza ishte shpallur, transaksionet e KESH-it vazhdonin, ndërkohë që kur shpallet një krizë, vendoset një regjim, një frenim i menjëhershëm i të gjitha transaksioneve, për të mbajtur situatën nën kontroll. Këtë e bëjnë ata që janë seriozë në qeverisje, por këta vazhdonin të bënim dëme financiare me miliona. Si nuk pyeti njëri këtu që ne vërtetë po i kërkojmë 200 milionë për t'ia dhënë OSHEE-së, por ku do të na çojë ky keqmenaxhim i tmerrshëm që krijoi këtë krizë? Borxhi që do të marrim është 200 milionë euro (t'u referohemi shifrave të tyre, jo tonave), kurse borxhet e papaguara të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve të Republikës janë 203 milionë euro. Ja ku janë 200 milionë euro, gati aq sa na duhen. Kush e mban përgjegjësinë për këtë? Këtu bëhet batërdi me OSHEE-në, që nuk mbledh dot as borxhet e veta, dhe ndërkohë borxhi vazhdon t'u rëndojë shqiptarëve. Si mund të prokurohet energjia, që shpyr kemi

disa të zotë, ustallarë të mëdhenj, që marrin borxh, që e dinë shumë mirë konjunkturën si do të jetë përqindja e interesit të borxhit vitin tjetër, kur thonë i kemi dalë përpara krizës duke i mbajtur paratë gjendje në bankë se interesat nuk do të rriten, se këta dinë edhe të gjithë konjunkturën e tregut? Këta që nuk parashikojnë dot krizën për një muaj, dy javë apo tri javë, janë të zotë të kenë vizionin e parashikueshmërisë së ecurisë së tregjeve financiare! Kjo është fare e qartë dhe asnjë njeri këtu nuk mund të ketë dilema, prandaj, të bëhemi seriozë dhe t'u flasim shqiptarëve drejt në sy për situatën ku jemi. Është shpartalluar administrimi i OSHEE-së dhe KESH-it. Ky është fakt, pavarësisht votimeve që bëhen këtu dhe idesë që nuk ka gjë për borxhin pa fund. Pas nesh le të ndodhë qameti.

Kjo është e vetmja devizë juaja, sepse një qeveri nuk mund të krenohet duke u krahasuar me qeverinë e mëparshme duke thënë që unë e kam buxhetin shumë të madh. Duhet të jemi të marrë të flasim për budallallëqe të kësaj natyre, ndërkohë që kemi një mal të madh me borxhe. Sa e kishim borxhin, sa e gjetëm dhe sa e kemi? Po t'i mbledhim të gjitha bashkë, shkon afër 100%. Pra, janë miliarda euro, por ne jemi shumë të lumtur se shtojmë buxhetin e borxhe. Kjo është qeverisja? Ta kemi ekonominë gjithmonë si mbi mina, që të kolapsojë brenda sekondit, kur dihet historia e kolapsit të ekonomive shumë të fuqishme, tek të cilat, edhe pse të vëna në asete natyrore ekonomike të pamata, kolapsi ka qenë i plotë? Ne këtu lumturohemi se marrim borxh dhe asnjë fjalë nuk thuhet. Cila është përgjegjshmëria? Vetë maxhoranca duhet të thoshte që ky ka qenë administrim mizerabël i të gjithë sektorit energjetik. Të gjitha këto qindra miliona euro të raportuara këtu me krenari nuk kanë dhënë asnjë gram rezultat, por vetëm krizë dhe sot vazhdojmë të paguajmë para, ndërkohë që 200 milionë euro janë aty të papaguara nga entet shtetërore. Entet shtetërore nuk paguajnë dyqind e ca milionë euro, kurse qytetarët që nuk kanë paguar energjinë elektrike, futen në burg. Njerëzit e bëjnë krahasimin, pavarësisht se këtu derdhen lumenj propagande. Sado që t'i përçmojnë qytetarët, të mendojnë se këta nuk kuptojnë dhe me një fjalim të gjatë dhe të lodhshëm mendojnë se i bindën, ata e shikojnë me sytë e tyre. Ai që nuk paguan energjinë shkon në burg, kurse për shkak të atyre që nuk paguajnë 200 milionë dollarë, gjendemi sot në situatën që kërkojmë borxh. Ata nuk kanë asnjë përgjegjësi dhe vazhdojnë të jenë të lumtur. Rrezik do t'i harxhojnë edhe këto para për rrush e kumbulla dhe pas gjashtë muajve do të shpikin krizën e radhës për të kërkuar paratë e radhës. Fakti është ky dhe nuk lëviz. Në 5 vjet borxhi është 2,3 miliardë euro. Dihet si është menaxhuar OSHEEja. Këto nuk janë shifrat e mia, por ndodhen në paraqitjen e projektbuxhetit. Po, të tyret janë. Nuk po u referohemi projeksioneve të vërteta, por shifrave të tyre. Po e njëjta gjë ka ndodhur edhe me ujësjellës-kanalizimet, pohuar vetë nga këta. Edhe pse janë shpenzuar 1 200 000 000 euro, botet e ujit lëvizin në mes të Tiranës.

Kjo është Shqipëria e vërtetë. Çfarëdo fjalimi të mbahet këtu, sado të ngrihet zëri dhe sado të flitet kodra pas bregut, për të mos i qëndruara temës, kjo është e vërteta. Ka një shpërdorim të tmerrshëm, shkatërrimtar, që i ka çuar të gjitha këto kompani të mëdha shtetërore në prag të falimentimit, jo se nuk kemi burime natyrore, jo se nuk kemi mundësi të administrohen shumë më mirë, sepse falë Zotit kemi kapacitete prodhuese në vend, nuk jemi një vend i varur 100% nga energjia, siç ka vende të tjera që varen 100% nga energjia e të tjerëve dhe nuk janë kurrë në krizë energjetike si puna jonë, por ky shpërdorim është kaq i tmerrshëm, kaq i frikshëm sa Kryeministri ikën. Atij i iket edhe për një arsye të madhe, sepse shumë këtu duartrokin dhe i bëjnë elozhe drejtësisë së re, por kjo bëhet se nuk funksionon drejtësia e re. Një drejtësi e kapur i mbyll sytë, se po të ishte një drejtësi e vërtetë, do të shikonte këtë seancë, do të shikonte shifrat publike që janë këtu, do të shikonte edhe realitetin dhe do të kuptonte sesi një Parlament, me këtë maxhorancë, paguan 200 milionë euro për të paguar hajdutët që kanë vjedhur deri tani sa janë shqepur. Kjo është e vërteta e kësaj seance dhe prandaj po e them publikisht: vota ime do të jetë kundër këtij akti.